




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT I VEÇANTË

Për të drejtat e fëmijëve
jetimë, përfshirë këtu
fëmijët e sistemuar në
institucionet rezidenciale të
përkujdesjes shoqërore, si
dhe të drejtat e fëmijëve që
shfrytëzohen për të punuar



Tiranë, Prill 2013



Save the Children

Botimi i këtij raporti u mundësua nga Save the Children

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre; ne i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

Këndvështrimet e autorëve të këtij dokumenti jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Save the Children - Rr. “Komuna e Parisit”, Lagjia 8, Pallatet 1 Maji, Vila “Lami”;

P.O. Box 8185, Albania

Tel: +355 4 2261840 / +355 4 2261929 / +355 4 2266227, Fax: +355 4 2263 428

Email: info.albania@savethechildren.org, Web Page: albania.savethechildren.net

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.	5
2. Të dhëna statistikore.	7
3. Kuptimi i kategorive të Fëmijëve Jetimë, Fëmijëve të vendosur në Qendrat Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, Fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar dhe Fëmijevë të rrugës.	10
4. Shkaqet e shfrytëzimit të punës së fëmijëve.	13
5. Pasojat psikologjiko-fizike që vërehen tek kategoritë e Fëmijëve Jetimë, Fëmijëve të vendosur në Qendrat Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, Fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar dhe Fëmijëve të rrugës.....	15
6. Legjislacioni shqiptar lidhur me mbrojtjen e këtyre kategorive vulnerabël.....	19
7. Ndërhyrjet e Avokatit të Popullit lidhur me të drejtat e fëmijëve jetimë.	25
8. Problematikat e konstatuara.	32
9. Konkluzione.	39

Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të drejtat e fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar.

1. Hyrje

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme, të politikave të mbrojtjes sociale. Në themel të tyre, pasqyrohen parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, detyrimet, që dalin nga objektivat e mijëvjeçarit të ri dhe instrumentet e tjera ndërkombetare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçante nga familja dhe institucionet shtetërore.

Një nga zhvillimet aktuale sot në botë, është anagazhimi i të gjithë shoqërive dhe mekanizmave të tyre qeverisë, për një botë të denjë për fëmijët, ku ata e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata, kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues. Pikërisht ky mjedis, duhet të shërbejë si nxitës për zhvillimin fizik, psikologjik, shpirtëror, shoqëror, emocional dhe kulturor të fëmijëve, si një çështje që tashmë është prioritet global.

Shoqëria shqiptare, është bërë pjesë e këtij angazhimi global, në realitetin e hidhur ku një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë në kushte të rënda dhe shpesh pa mbështetjen e prindërve të tyre, siç janë edhe fëmijët jetimë, fëmijët e rrugës, fëmijët e shpërngulur dhe ata refugjatë, fëmijët e trafikuar, fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht dhe seksualisht, dhe fëmijët që janë në burgje.

Realiteti shqiptar prezanton një shoqëri ku problemet sociale janë të mprehta, ku mirëqenia dhe mjedisi ku jetojnë janë çështje të prekura përditë, por që çdo ditë nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtet-shoqëri, ku shtresa dhe kategori të ndryshme sociale vulnerable, kërkojnë më shumë barazi dhe integrim me pjesën tjetër të shoqërisë.

Varfëria e dukshme, mbetet një pengesë e madhe për përballimin e nevojave, mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të fëmijëve, pasi fëmijët janë shumë të prekshëm ndaj varfërisë, e cila godet rrënjët e mundësive për zhvillim, trupat e tyre ende në rritje dhe mendjet e tyre të brishta.

Në këto kushte, respektimi dhe vlerësimi i dinjitetit të fëmijëve në përgjithësi, veçanërisht i kategorive të fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar janë një sfidë e madhe që, lidhet pazgjidhshmërisht me afirmimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në një shoqëri që përditë aspiron vendosjen dhe konsolidimin e vlerave demokratike. Udhërrëfyes të pazëvendësueshëm në këtë perpjekje jetike globale për shoqëritë demokratike, mbeten

parimet e interesit më të lartë të fëmijës, të mosdiskriminimit, të pjesëmarrjes, mbijetesës dhe zhvillimit.

Fëmijëria konsiderohet nga disiplinat mjekësore, psikologjike e pedagogjike si një periudhe vendimtare për të ardhmen e zhvillimit të fëmijëve si individë dhe si qytetarë. Rëndësia e kësaj periudhe për gjithë zhvillimin e mëpasme e bën të domosdoshme që, për ta të tregohet kujdes i posaçëm për t'ua plotësuar nevojat zhvillimore. Njëra prej tyre është nevoja për siguri dhe pa plotësimin e kësaj nevojë është e pamundur të kemi individë të shëndetshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm.

Jo pa qëllim në këtë raport fokusi është vendosur në dy grupime specifike, përkatësisht, fëmijët jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe fëmijët që shfrytëzohen për të punuar, të cilët përfaqësojnë kategori sociale që kanë marrë përpjestime shqetësuese në periudhen e tranzicionit dhe që sot njihen si kategori vulnerabel.

Përtej aspektit formal të formulimit dhe përgatitjes së një raporti, të gjithë ne, në jetën e përditëshme përballlemi në rrugët e qyteteve tona me fëmijët jetimë dhe të tjerë syresh që, punojnë pa marrë parasysh veten dhe dëshirat e moshës, për të mbijetuar së bashku me familjet e tyre. Ky realitet i dhimbshëm është dhe duhet të përbëjë shqetësim për të gjithë ne, politikëbërësit dhe shoqërinë shqiptare në tërësi, pasi individët e ngërthyer keqas në kthetrat e pamundësisë, varfërisë, pabarazisë dhe shfrytëzimit janë vetëm fëmijë, që presin të shohin të njejtat mundësi, të njejtin trajtim, të njejtën mirëqenie, sikurse pjesa tjetër e bashkëmoshatarëve të tyre.

Nisur nga problematikat që shoqërojnë jetën e përditëshme të këtyre grupimeve, raporti synon të evidentojë problemet që ata hasin çdo ditë dhe shtrirjen e tyre, si dhe të ndihmojë me rekomandime konkrete, përballimin dhe trajtimin pozitiv të fenomeneve të shfaqura, duke bërë që të evidentohen vlera praktike dhe të zbatueshme për përmirësimin e gjendjes aktuale.

2. Të dhëna statistikore

Të dhënat statistikore, që jepen në këtë raport janë selektuar nga të dhëna të siguruara nga institucione shtetërore, nga OJF-të, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të target grupeve të specifikuara në raport, si dhe nga media.

Nga të dhënat e siguruara nga institucionet shtetërore, vendi ynë, njihet si një nga vendet me popullsi të re në Europë.

Bazuar në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011, rezulton se popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë është 2.821.977 banorë. Ndërkohë që, numri i popullsisë nga Censuri i vitit 2001 ishte 3.069.275. Vihet re se, numri i popullsisë në vitin 2011 është zvogëluar me rreth 8% gjatë dhjetë viteve, gjë që flet për një plakje të popullsisë. Supozohet që shkaqet kryesore të zvogëlimit të popullsisë janë emigrimi në shkallë të gjerë dhe rënia e lindshmërisë.¹

Përsa i përket numrit të individeve nën moshën 18 vjeç, rezulton se, numri në total është 847.302 persona.² Krahasuar me numrin total të popullsisë rezidente, del që pak më shumë se 30% e popullsisë janë të grupmoshës 0-18 vjeç, pra fëmijë.

INSTAT nuk disponon të dhëna mbi numrin e fëmijëve jetimë dhe as numrin e fëmijëve të cilësuar si “fëmijë të rrugës”. Përsa i përket nivelit zyrtar të varfërisë, ky institucion konfirmon se, “disponon të dhëna vetëm mbi nivelin e varfërisë në vend bazuar në rezultatet më të fundit të anketës së kryer për këtë qëllim – Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2008, sipas së cilës, niveli i varfërisë në vend është 12.4 përqind”.³

Rrjeti i shërbimit social raporton se mbulon me ndihmë sociale 65-67%, të individëve që janë në nevojë, numri i të cilëve arrin në 464800 persona, ose 14% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Realisht, numri i atyre që kanë nevojë për asistencë është mbi 700.000 persona. Nga 700.000 individe që kanë nevojë për asistencë, 184.000 janë fëmijë, 31.000 prej të cilëve janë fëmijë jetimë. Mbi 2/3 e kësaj moshe përballen me ekstremin e përpjekjeve rraskapitëse për mbijetesën, por më të prekurit nga ky ekstrem varfërie mbeten fëmijët jetimë. Një pjesë shumë e vogël e tyre marrin asistencë sociale, e cila në masën e përfitimit të saj mbulon vetëm 5% të nevojave minimale të jetes së tyre. Nga 31.000 fëmijë jetimë në mbarë vendin, vetëm 400 prej tyre trajtohen në 9 qendra rezidenciale qeveritare dhe 360 të tjerë, në 16 qendra joqeveritare (OJF). 100.000 persona me aftësi të kufizuara, mes të cilëve një numër i madh jetimësh, gjenden në

1. INSTAT, Botimi “Censuri i Popullsisë dhe Banesave-Rezultatet kryesore”, Shtypshkronja “Adel Print”, viti 2012 Tiranë, faqe 7.

2. Ibid, faqe 47.

3. Ky informacion është dhënë në shkresën e INSTAT nr.865/1 datë 22.10.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

të njejtën situatë varfërie e përpjekjesh për mbijetesë.⁴

Në kuadër të OJF-ve që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë, "...janë deklaruar publikisht 140 shoqata që merren me trajtimin e shtresave të varfëra dhe fëmijëve në nevojë, veçanërisht të fëmijëve jetimë dhe fëmijëve të ngujuar nga gjakmarrja".⁵

Në një studim të kryer në vitin 2009 rezulton se, të rinjtë (jetimë biologjikë ose socialë) që largohen nga përkujdesja fillojnë jetën e pavarur pa arsimim të përshtatshëm, pa punë dhe pa strehim, dhe në rrezik të lartë për t'u përfshirë në aktivitete kriminale, apo për t'u bërë pre e trafikimit dhe e problemeve të tilla. Shumë prej tyre vazhdojnë jetën në varfëri dhe përjashtim social. "Të dhënat tregojnë që 197 të rinj mbi moshën 18 vjeç jetojnë aktualisht në konviktet e shkollave të mesme. Nga 900 të rinj, të cilët kanë dalë nga konviktet, 356 të moshës 18-25 vjeç marrin ndihmë ekonomike, 217 mbi moshën 25 vjeç janë të papunë. I njëjti burim evidenton se mosha e largimit nga përkujdesi institucional rezidencial është përcaktuar mosha 15 vjeç ose deri në 17 vjeç në rast se, i riu/e reja nuk ka përfunduar shkollën 9-vjeçare. Legjislacioni parashikon që të rinjtë duhet të kenë një plan individual, i cili përcakton mundësitë për arsimimin, bursë dhe mundësi strehimi. Për të rinjtë të cilët përfitojnë statusin e jetimit, bursat e shkollimit, akomodimi në konvikt, kujdesi shëndetësor dhe transporti publik falas duhet të jenë prioritet nga strukturat përkatëse. Të rinjtë pa kujdes prindëror, mbi 18 vjeç, përfitojnë nga ndihma ekonomike një shumë prej 3000 lekësh në muaj, pasi përfundojnë shkollën e mesme ose të lartë, deri në momentin që janë pa punë".⁶

Në botimin e publikuar në Tetor 2009, SOS, Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, "Të rinjtë pa kujdes prindëror – Praktikë, legjislacioni dhe të drejtat", është evidentuar se eksperiencia e kujdesit rezidencial, luan rol kyç në jetën dhe të ardhmen e këtyre të rinjve që largohen/lënë këtë shërbim. Mbulimi i dobët me shërbime mbështetëse gjatë periudhës kur të rinjtë lënë institucionin (14-18 vjeç dhe pas 18 vjeç) e më pas, lë gjurmë në jetën e tyre në të gjitha planet, arsimim, punësim, strehim etj. Kjo jo vetëm thëllon disavantazhet dhe i kthen në grupe me marginalizim të shumëfishtë, por edhe u dhunon një pjesë të mirë të të drejtave bazë. Megjithatë ka një numër aktoresh të qeverisjes qendrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë

4. Rezolutë e Takimit Kombëtar të Jetimëve të Shqipërisë "Për integrimin e Shqipërisë bashkë me jetimët në Europën e Bashkuar", Tiranë, faqe 2-3, e shpallur nga Instituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, Tiranë më 20 Maj 2012. Ky dokument gjendet në website: www.nifao-orfan.org

5. Ibid..faqe 3.

6. Ky informacion gjendet në website: lajme.parajsa.com/Shqiperia/id_250604/

kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkëmbimit të informacionit. Gjithashtu, shpërndarja e burimeve financiare në mbështetje të të rinjve me shërbime, është e pamjaftueshme dhe nuk sjell ndryshime të qenësishme në pavarësimin e tyre.

Në të dhënat e siguruara nga ana e Shërbimit Social Shtetëror,⁷ rezulton se, në rrjetin e institucioneve publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror të licensuara nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, janë trajtuar gjithsej 585 fëmijë në nevojë, nga këta 256 në institucione rezidenciale publike dhe 329 të tjerë, në institucione rezidenciale jopublike. Ndërkohë janë trajtuar 1609 fëmijë në 38 shërbime në komunitet, 70 fëmijë në 3 institucione ditore publike dhe 4140 fëmijë në 48 qendra ditore të OJF-ve. Janë trajtuar 37 fëmijë në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, 87 fëmijë me aftësi të kufizuar në 7 qendra të zhvillimit dhe 23 fëmijë në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikimit. Nga të dhënat rezulton se rreth 80% e numrit të fëmijëve janë trajtuar në shërbimet jorezidenciale, gjë që tregon përvijimin e tendencës së deinstitutionalizimit⁸ të shërbimeve dhe rritjen graduale të peshës specifike të kujdesit jorezidencial.

Nga statistikat e regjistrit kombëtar me të dhënat e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike, rezulton se 87% e fëmijëve (të cilët përfitojnë shërbime në këto qendra), vijnë nga familje me probleme social-ekonomike.

7. Shkresa e Shërbimit Social Shtetëror nr.1064/1 datë 25.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

8. Deinstitutionalizimi, ka të bëjë me konceptin e ri të shërbimeve rezidenciale të formës Shtëpi-Familje. Sipas këtij procesi, fëmijëve në nevojë u ofrohen shërbime alternative me bazë komunitare dhe kujdestarie në familje, ose birësimi.

3. Kuptimi i kategorive të Fëmijëve Jetimë, Fëmijëve të vendosur në Qendrat Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, Fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar dhe Fëmijëve të rrugës.

Në grupimin e *fëmijëve jetimë*, ose *fëmijëve jashtë kujdesit prindëror*, përfshihen fëmijët 0-14 vjeç dhe të rinjtë (fëmijët) 14-18 vjeç, të cilët nuk jetojnë me prindërit e tyre për shkak të: vdekjes së të dy prindërve; heqjes dorë nga kujdestaria prindërore apo braktisja; paaftësisë së përkohshme ose të përhershme të prindërve për t'u kujdesur (sëmundje apo vuajtje dënimi me heqje lirie); vendosjes së vullnetshme të përkujdesit nga strukturat administrative (shërbimet sociale); heqjes të së drejtës prindërore (në bazë të një vendimi të formës së prerë dhënë nga gjykata).

Institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, përbëjnë struktura të cilat përkujdesen për fëmijët jashtë kujdesit prindëror. Jetesa në to është e organizuar në mënyrën e jetesës në grupe, ku një personel me pagesë kujdeset për fëmijët dhe jo mbi bazën e jetesës në familje. Këto struktura mund të jenë me bazë komunitare dhe strehojnë fëmijë jashtë kujdesit prindëror nga komuniteti përreth, ose mund të jenë institucione rezidenciale kombëtare, të cilat kujdesen për fëmijët që vijnë nga më shumë se një komunitet.

Në grupimin e *fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar*, do të përfshihen të gjithë ata fëmijë që kryejnë punë në ndihmë të familjes së tyre, apo për nevojat e tyre të mbijetesës, pa mbushur moshën 18 vjeç. Termi "shfrytëzim i punës së fëmijëve", këtu përdoret vetëm për ato forma punësimi ose punë të papaguar që, shkel të drejtat e fëmijëve dhe që duhet të ndaloher.

Pavaresisht moshës të lejuar për punë, të përcaktuar taksativisht nga ligji, puna e fëmijëve nën moshën e parashikuar me ligj është një dukuri që po haset dendur. Puna e fëmijëve është gjithashtu një pengese për zhvillimin njerëzor në vend dhe si e tillë nuk mund të trajtohet e izoluar nga konteksti i gjerë në të cilin ndodh.

Aktualisht nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e fëmijëve që punojnë dhe llojet e punës që ata bëjnë, por mund të dallohen dy kategori të fëmijëve që punojnë:

1. Fëmijë që punojnë në sektorin formal të ekonomisë.
2. Fëmijët që punojnë në sektorin joformal të ekonomisë, kryesisht në rrugë, si: shitës ambulante, lypsa, pastrues të makinave në semafore etj, si dhe në një nga format më të këqija të punës së fëmijëve që është edhe trafikimi i fëmijëve për qëllim shfrytëzimi, si për shfrytëzim seksual, për vjedhje, përfshirje në aktivitete të paligjshme etj.

Është e rëndësishme të sillen në vëmendjen e të gjithë aktorëve të interesuar dhe politikëbërësve në këtë fushe, kuptimi i Formave më të Keqija te Punës së Fëmijëve, sipas përcaktimeve të bera në Konventën e ILO-se nr.182, e cila përfshin të gjithë fëmijët derisa

mbushin moshën 18 vjeç.⁹

Përcaktimi “fëmijët e rrugës” është ende i diskutuar, por shumë zbatues dhe politikëbërës të UNICEF-it konceptojnë me këtë term djemtë dhe vajzat nën 18 vjeç, për të cilët “rruga” (përfshirë këtu banesat e paokupuara dhe djerrinat), është bërë vendi i burimit të tyre të jetesës dhe që janë të mbrojtur në mënyrë jo të përshtatëshme.

Në termin “fëmijët e rrugës”, përfshihen të gjithë ata fëmijë, jetimë biologjike apo edhe sociale, të cilët për shkak të vështirësive të mëdha ekonomiko-sociale të familjeve të tyre, detyrohen që në moshë ende të njomë, të lypin, shesin ose rrinë në rrugë për të siguruar të ardhura minimale për vete dhe familjen e tyre. Termi i përdorur në këtë rast nuk duhet të ngatërrohet me zhargonin “fëmijë rrugaçë”, i cili i referohet individëve minorenë keqbërës. Terreni social në të cilin ata punojnë (rruga), ndikon seriozisht në shfaqjen e problemeve të zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe të deformimeve të karakterit, që shpesh janë me natyrë të pariparueshme, pasi “tek fëmijët e rrugës evidentohen një varg problemesh specifike që kanë të bëjnë me zhvillimin e tyre fizik e sidomos intelektual, me zhvillimin dhe prapambetjen individuale dhe sociale”.¹⁰

Nga pikepamja e moshës shumica e fëmijëve të rrugës janë të moshës 11-16 vjeç dhe në përgjithësi, asnjë prej fëmijëve që kalon në rrugë nuk sillet pa patur synime të fitimit ose perfitimit material.¹¹ Aktiviteti i punës, i shitjes, lypjes etj, është kryesori për 95% të fëmijëve të rrugës. Askush nga fëmijët e rrugës nuk deklaron si aktivitet të tij kryesor shkollën apo lojen, të cilat duhej të ishin veprimtaritë kryesore.¹²

9. Neni 3 i Konventes së ILO nr.182, përcakton format e këqija të punës së fëmijëve:

- a) Të gjitha format e skllavërisë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavërues dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimin pa dëshirë ose i detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- b) Përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmijë për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- c) Përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmijë për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike, sikundër janë përkufizuar në traktatet ndërkombëtare;
- d) Puna, e cila për shkak të natyrës apo rrethanave në të cilat zhvillohet, mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.

Kategoria e (d) referohet në Konventën 182 si Punë e rrezikshme e Fëmijëve dhe ka të bëjë me punën që mund të rezultojë me vdekje, lëndime (shpesh të përhershme) apo sëmundje (shpesh kronike) si pasojë e standardeve të ulëta të vendit të punës, të sigurisë dhe shëndetit.

10. Projekt i financuar nga UNICEF-Fëmijët e rrugës (Studim)-Tiranë, faqe 17. Ky projekt është zhvilluar në qytetet Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Berat, duke mbajtur parasysh faktorët si, numrin e madh të popullsisë, pozitën gjeografike, afërsinë me zonat e tjera të banuara dhe ngarkesën e problemeve sociale.

11. Projekt i financuar nga UNICEF-Fëmijët e rrugës (Studim)-Tiranë, faqe 24. Ky projekt është zhvilluar në qytetet Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Berat, duke mbajtur parasysh faktorët si, numrin e madh të popullsisë, pozitën gjeografike, afërsinë me zonat e tjera të banuara dhe ngarkesën e problemeve sociale.

12. Ibid faqe 27.

Sigurisht fëmijët që vijnë nga familjet e varfra dhe me status të dobët social, romët, fëmijët jetimë dhe ata pa kujdesin prindëror, kanë qenë dhe janë viktimat të lypsarisë, si rezultat i abuzimit permanent të prindërve të tyre apo tutoreve, të cilët i shfrytëzojnë maksimalisht, duke u shkaktuar këtyre fëmijëve një traumë të rëndë të aspektit psiko-emocional, për rrjedhojë, edhe një rrezik potencial të shëndetit fizik dhe atij mendor.¹³

Paratë e fituara me punën e fëmijëve futen në buxhetin familjar. Disa familje të tilla jetojnë vetëm më të ardhurat që sigurojnë këta fëmijë duke punuar zakonisht me orë të zgjatura. Në disa prej tyre ata edhe rrihen nese nuk arrijnë "t'i bëjnë paratë e pritura". Kjo përbën një rënë anë të medaljes. Anën tjetër e përbën fakti se në rrugë këta fëmijë i ekspozohen formave të shumëfishta të dhunës: dhunës se grupeve rivale që shesin në territore fqinje dhe që duan t'u rrëmbejnë klientelën, dhunës së kamerierëve të lokaleve të shumta ku këta hyjnë për të shitur mallrat e tyre. Shfrytëzimi i tyre për punë dëmton të drejtën e tyre për t'u arsimuar. Një pjesë e tyre shkojnë herë pas here në shkollë, ndërsa një pjesë e ka braktisur përfundimisht shkollën.

Kategori tjetër fëmijësh që futen në punë janë fëmijët e fshatit. Familjet fshatare të cilat jetojnë me ekonominë e vogël të bagëtisë dhe të tokës që kanë, kanë zakonisht nevojë për krahë pune. Kjo nevojë bëhet më e mprehtë nese prindërit janë të pafuqishëm dhe nëse fëmijët e rritur të familjes janë në emigracion. Në këto kushte barra u bie fëmijëve. Këta zakonisht dërgohen me bagëtinë. Kjo nuk është punë shumë e lodhshme për ta, por iu dëmton frekuentimin e shkollës.

Një kategori e veçantë e fëmijëve që shfrytëzohen janë fëmijët romë. Ndryshe nga fëmijët që shesin dhe që janë përgjithësisht nga Shqipëria e Mesme dhe ajo e Veriut, këta kanë prirjen të lypin dhe të lajnë xhamat e makinave. Këta dërgohen të lypin ose të punojnë nga të rritur të cilët grumbullojnë edhe paratë që këta të fundit arrijnë të mbledhin.

13. Ilir Çumani, Artikulli: "Lypsaria, një kabanë alarmi për të gjithë...!"-Gazeta Panorama, datë 15.08.2012, Tiranë, faqe 16.

4. Shkaqet e shfrytëzimit të punës së fëmijëve

Ka shumë arsye që i nxisin fëmijët drejt punës, sidoqoftë faktori më i rëndësishëm mbetet varfëria. Familjet e varfra i shtyjnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të shtojnë të ardhurat e tyre të pamjaftueshme.

Varfëria është njëkohësisht shkak dhe pasojë e punës së fëmijëve. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë komponentët kryesorë të “ekuilibrit të ulët ekonomik” në nivel të familjes, komunitetit dhe vendit. Për këtë arsye, puna e fëmijëve është një pikë themelore për ndërhyrje në masat që merren për zbutjen e varfërisë dhe mbrojtjen sociale.

Përveç varfërisë, ka shumë faktore të tjerë që kontribuojnë në punën e fëmijëve:

Qëndrimi përkrahës ndaj punës së fëmijëve – Prindërit (mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi) mund ta shohin punën e fëmijëve si pjesë e edukimit të tyre, veçanërisht kur arsimimi ekzistues nuk ofron përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit mund ta mbështesin punën e fëmijëve si një mënyrë për t’i mbajtur fëmijët të sigurt, në disa zona ku fëmijët mund të diskriminohen, apo të jenë subjekt i dhunës në shkolla.

Mjedis jo i favorshëm familjar – familjet me një prind, me kryefamiljar të sëmurë apo të paaftë fizikisht, varësia nga alkooli apo nga droga e prindërve, paaftësia prindërore, si dhe abuzimi e vendosin fëmijën në rrezik të madh për t’u përfshirë në punën e fëmijëve.

Mungesa e qasjes në arsim – kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të edukimit, shpesh janë shumë të larta për prindërit që të mundësojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët dhe/ose shkollat janë në një distance shumë të madhe.

Diskriminimi – minoritete apo komunitete të caktuara kanë më pak qasje në arsim apo në tregun e punës, prandaj edhe kjo shton mundësinë që këta fëmijë të kryejnë detyra të caktuara që në moshë të rë. Për më tepër, ndarja e punës në bazë gjinore mund t’i detyrojë meshkujt dhe femrat që të kufizojnë perspektivat e tyre të punës deri në një shkallë të caktuar që nuk kërkon arsimim, por “praktikë pune” që nga moshat e reja, përfshirë dhe punën në shtëpi.

Përhapja e sektorit joformal dhe mungesa e zbatimit të ligjit – Mungesa e kontratave të punës dhe e së drejtës së krijimit të shoqatave kolektive në sektorin joformal e bën më të vështirë

mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës, si dhe vetë identifikimin e fëmijëve që punojnë.

Shkalla e lartë e migrimit – migrimi ka luajtur një rol në dobësimin e mbështetjes sociale për fëmijë.

Moszbatimi i parimit të sundimit të ligjit – ka lejuar ekonominë informale të lulëzojë dhe korrupsionin që të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo gjë ka ndikim të drejtpërdrejtë në:
a) rastet e formave të keqija të punës së fëmijëve që kanë lidhje me aktivitetet kriminale (aktivitete të jashtëligjshme, trafikim dhe prostitucion – kur një gjë e tillë është kriminalizuar), dhe
b) në zbatimin e ligjeve dhe politikave të lidhura me punën e fëmijëve.

Ekzistenca e përkohshme e një “mungese vlerash” – në të cilin presioni i konsumimit perëndimor në konkurrencë me vlerat tradicionale, si dhe tërheqja personale në masë ekstreme, sjellin:
a) prishjen e bazës së vlerave të familjes dhe komunitetit; dhe b) rritjen e rrezikshmërisë ndaj fëmijëve.

Për shkak të mungesës së një mbikëqyrjeje dhe kujdesi të duhur, rruga është bërë vendi kryesor për shoqërizimin e fëmijëve.

5. Pasoja psikologjiko-fizike që vërehen tek kategoritë e Fëmijëve Jetimë, Fëmijëve të vendosur në Qendrat Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, Fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar dhe Fëmijëve të rrugës.

- Pasoja psikologjike tek fëmijët jetimë

Qenia jetim i një fëmijë le pasoja të pariparueshme psikologjike, të cilat mund të riparohen apo reduktohen vetëm në një mjedis të ngrohtë familjar dhe shoqëror, i cili e pranon dhe e sheh atë të barabartë në çdo aspekt.

Në shumë raste nga studime të shumta psikologjike që i janë bërë kësaj kategorie, tek fëmijët pa prindër apo edhe vetëm me një prind, nga ana e shoqërisë vihet re një qëndrim injorues, neglizhues, ku shfaqen hapur emocionet negative që manifestohen ndaj këtij fëmijë. Ky qëndrim përbën edhe shkakun fillestar që tek fëmija të lindi agresiviteti ndaj atyre që e refuzojnë, lenë pas dore, apo edhe që duan "t'a heqin qafe".

Një fëmijë i tillë nuk ka fatin e pasjes së një jete normale. Ai ndjen peshën e një damke të dhimbshme sociale, refuzuese dhe dyshuese ndaj tij. Kur fëmija rritet ndjen psikologjikisht se është ndryshe nga bashkëmoshatarët e tjerë. Gjendja e një jetimi vështirësohet në stadin e adoleshencës, kur krizës së identitetit të moshës i bashkohet kriza personale që ky individ mbart në vetvete, kjo pasi origjina e indentiteti personal dhe familjar nuk ekziston, duke i munguar kështu edhe objekti i identifikimit. Pikërisht identiteti i paqartë, i çrregullt dhe i shfityruar e bën konstruktin individual psikologjik të ligësht dhe të deformuar. Për këto arsye, këta individë kanë çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

- Pasoja tek fëmijët që shfrytëzohen për punë.

Fëmijët që shfrytëzohen për punë dëmtohen në aspektin psikologjik, moral dhe fizik. Përmasat se deri në ç'skallë preken fëmijët nga forma të ndryshme të punës, nga pikëpamja e shëndetit dhe e sigurisë, jepen në vijim:

- plagosjet apo gjymtimet fizike që shkaktohen nga makineritë që nuk janë mirëmbajtur mirë, si dhe mostrajnimet apo kryerjes së proceseve të punës të papërshtateshme për fëmijët, (rasti i shpërthimit të Gërdecit dhe videove që u shfaqen në televizione të ndryshme ku shiheshin fëmijë të mitur duke çmontuar municion luftarak).
- helmimi nga pesticidet, gjatë punës në bujqësi.
- mungesa e rritjes është e dukshme tek fëmijët që punojnë, të cilët janë më të shkurtër dhe më të dobët sesa fëmijët e tjerë; këto mangësi ndikojnë edhe në jetën e tyre më vonë kur këta të jenë në moshë të rritur.
- problemet afatgjata shëndetësore, si sëmundjet respiratore, apo lloje të ndryshme të sëmundjeve të rënda, janë te zakonshme në vendet ku fëmijët detyrohen

- të punojnë me kimikate të rrezikshme.
- HIV/AIDS-i apo sëmundjet të tjera ngjitëse seksuale janë të përhapura në mes të fëmijëve që detyrohen të trafikohen çdo vit. Shtatzënitë e padëshirueshme, varësia nga droga apo sëmundjet mendore janë po ashtu të zakonshme në mes të fëmijëve që përdoren për shfrytëzim seksual.
 - Në veçanti fëmijët e rrugës, shfaqin një sërë problemesh specifike që kanë të bëjnë me zhvillimin e tyre fizik dhe sidomos atë intelektual, si dhe me zhvillimin dhe prapambetjen individuale dhe sociale, për shkak të mungesës së kushteve normale për zhvillimin e tyre psiko-fizik.
 - Në komunikimin me ta vihet re në mënyrë evidente një prapambetje relative në nivelin e tyre të kujtesës, të mendimit, të zhvillimit të gjuhës, si dhe sjellje dhe edukatë.¹⁴
 - Në aspektin fizik, shumica e këtyre fëmijëve shfaqin handikape fizike ose mendore të lindur, ose të bërë nga jeta e vështirë dhe kujdesi minimal për zhvillimin e tyre. Edhe ajo pjesë e tyre që nuk ka defekte të lindura mendore apo fizike, vetëm nga rruga, jeta sedentare, stresi, ankthi etj, pësojnë deformacione të rënda fizike apo mendore, të cilat shpesh bëhen të pakorrigjueshme.¹⁵

Këta fëmijë të detyruar prej kushteve socialo-ekonomike edhe pse rrinë në rrugë, në vetvete nuk e parapëlqejnë qëndrimin e tyre atje. Ky qëndrim vjen pasi fëmijët janë në gjendje të kuptojnë pozitën e tyre dhe të shprehen se, ata janë kundër këtij “statusi”, i cili sjell për pasojë diskriminim social.

- Pasojat e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve

Pavarësisht nga burimi i saj, dhuna ndaj fëmijëve mund të ketë shumë pasoja. Studimi i këtyre pasojave është një çështje e ndërlikuar. Duke qenë se këto pasoja përbëjnë një kategori socio-psikologjike studimi, në këtë raport kemi identifikuar një sërë pasojash, të cilat janë referuar në studime të bëra specifikisht në këtë drejtim.¹⁶

Së pari duhet shënuar se, fëmijët veçanërisht nuk kanë një fjalor të pasur për të përshkruar pasojat e dhunës, sidomos të

14. Projekt i financuar nga UNICEF-Fëmijët e rrugës (studim)-Tiranë, faqe 17.

15. Ibid.. faqe 17-19.

16. Referenca në këtë rast, bëhet në gjetjet e identifikuara në botimin e Qendrës së Zhvillimeve Humane; “Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri”-Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Shqipëri, Tiranë, viti 2006.

dhunës psikologjike tek ta. Kjo ndoshta shpjegohet nga fakti se në çastin kur përdoret dhuna, zor se del koha për të menduar për pasojat e saj.

-Pasojat e dhunës fizike mbi fëmijët

Konstatimi i parë i madh dhe i rëndësishëm është se, si prindërit, mësuesit, ashtu edhe vetë fëmijët pohojnë në masë se përdorimi i dhunës sjell pasoja të dukshme fizike si: dhembje; plagosje të caktuara të viktimave të dhunës; shenja që mbeten edhe pas shërimit të plagosjeve; gjymtime në kuptimin e humbjes së aftësive të mëparshme fizike për shkak të përdorimit të dhunës, etj.

Duhet theksuar se, ndërsa dhuna fizike mbi fëmijët nuk është vetëm dhe pastërtisht dhunë fizike. Ajo është në të njëjtën kohë edhe dhunë psikologjike. Efektet psikologjike të saj lidhen me ashpërsinë e lëndimit fizik dhe me mënyrën e ushtrimit të saj.

-Pasojat e dhunës psikologjike mbi fëmijët

Konstatimi i dytë i rëndësishëm i përdorimit të dhunës ka të bëjë me pasojat psikike të saj. Në këtë grup pasojash mund të dallohen disa nëngrupe.

-Pasojat që prekin nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të fëmijës.

Është fjala këtu për pasoja të tilla si: kultivimin e frikës dhe zhvillimin e saj deri në nivelin e një mekanizmi vetbllokues; kultivimin dhe zhvillimin e ndjenjave të fajit dhe të turpfit; kultivimin dhe zhvillimin e ndjenjave të pakënaqësisë, vetmisë. Kompleksi i ndjenjave negative që, pasojnë përdorimin e dhunës sjell edhe një varg ndjenjash të tjera si pesimizmi, lëndimi, inferioriteti, vetmia, fyerja, ndrojtja, nervozizmi, humbja e besimit në vete.

-Pasojat që prekin mundësinë zhvillimore të fëmijës

Këtu është fjala për humbjen e aftësive të mëparshme psikike në kuptimin e dëmtimit të vëmendjes, të kujtesës, të aftësive për t'u shoqëruar me të tjerët, të aftësisë për pavarësi dhe iniciative. një dëmtim i këtij niveli, në disa raste ekstreme çon deri në çrregullimë të rënda psikike të fëmijës.

- Kultivimi i sjelljes së dhunshme

Nëngrupi i tretë i pasojave të dhunës psikike është ai i kultivimit të sjelljes së dhunshme. Njëra nga pasojat psikike më të dukshme të dhunës mbi një kategori të caktuar fëmijësh, sidomos djemsh, është përvetësimi i modelit të sjelljes së dhunshme

që të rriturit përdorin mbi ta. Të gjithë e pranojnë se fëmijët e dhunuar janë fëmijë dhunues. Ata janë të tillë që në momentin që dhunohen dhe nuk është nevoja të pritët që ata të jenë të tillë në të ardhmen. Ata hakmerren për dhunimet që iu behen si ndaj dhunuesve të tyre, ndaj vëllezërve e motrave më të vogla, ashtu edhe ndaj shokëve e shoqeve të tjerë në shkollë e jashtë saj.

Përvetësimi i modelit të sjelljes së dhunshme përben kështu një rën nga pasojat e dukshme të efektit psikik të dhunës së të rriturve. Të rriturit vënë re se sjelljet e dhunshme të fëmijëve të tyre janë shumë të ngjashme me sjelljet e dhunshme që ata vetë kanë përdorur ndaj tyre. Modelimi psikik i të dhunuarve rezulton i ngjashëm me modelin psikik të dhunuesve të tyre. Pasoja e modelimit psikik agresiv nuk është një pasojë që vjen menjëherë pas një përdorimi të caktuar dhune. Ajo më shumë se kaq është një rezultante e shumë akteve të përdorimit të dhunës dhe kështu ajo përbën një pasojë të ngulitur fort në psikikën e fëmijës. Kjo do të thotë se çrrenjosja e kësaj sjelljeje dhunuese nuk është e lehtë.

Një pasojë me e menjëhershme, pra që shoqëron aktet e dhunës mbi fëmijët është ajo e rebelimeve, sidomos të djemve, ndaj dhunës së përdorur mbi ta. Është fjala për akte të rebelimit të vrullshëm të fëmijëve, sidomos kur këta janë adoleshentë. Rebelimi i tyre thuhet se shfaqet me kokëfortësi, me refuzimin e frekuentimit të shkollës, me largimin nga shtëpia, me emigrimin, etj.

Konstatimi i tretë lidhur me pasojat e dhunës mbi fëmijët është se të rriturit, sidomos prindërit, janë më të ndërgjegjshëm për pasojat fizike, sesa për pasojat psikike të dhunës mbi ta. Pasojat e dhunës fizike janë më të dukshme dhe ato nxisin ndjenja pendimi të përdoruesit e dhunës. Nuk ndodh kështu me shkallen e ndërgjegjesimit për pasojat e dhunës psikike. Kjo do të thotë se, ajo tolerohet me shumë prej tyre dhe se efektet e saj nuk vlerësohen siç duhet.

6. Legjislacioni shqiptar lidhur me mbrojtjen e këtyre kategorive vulnerabel.

Legjislacioni në këtë fushë përfshin një gamë të gjerë aktesh normative, të cilat synojnë të sigurojnë mbrojtjen e veçantë ndaj individëve të kategorizuar si “fëmijë”. I pasuruar me një sërë aktesh ndërkombëtare që përcaktojnë standarde për garantimin e të drejtave të “fëmijës”, ky legjislacion paraqet një përpjekje të dukshme për afirmimin e këtyre të drejtave. Më poshtë pasqyrohet një listë e akteve më të rëndësishme në këtë këndvështrim, duke ruajtur rezervën e arsyeshme që, listimi në vijim nuk përfaqëson një renditje shteruese të të gjithë akteve në këtë fushë.

Këto akte, jepen në vijim:

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, miratuar me Ligjin nr.8417 date 21.10.1998, është akti themeltar që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në përgjithësi. Në këtë akt, fëmijët janë një kategori e veçante e individëve, të cilët gëzojnë mbrojtje dhe iu garantohen një sërë të drejtash. Në dispozita të caktuara të Kushtetutës, roli dhe natyra përkujdesëse e shtetit shfaqet në atribuimin e një kujdesi të veçantë atyre personave që janë më të brishtë, konkretisht “fëmijëve”, duke afirmuar kështu të drejta dhe një politikë me efekte pozitive.¹⁷
- **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, aderuar në vitin 1955.
- **Konventa Europiane për mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut**, Konventa e miratuar nga Këshilli i Europës, ka hyrë në fuqi në vitin 1953, dhe është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr.8136 date 31.07.1996.
- **Pakti i OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike**, ratifikuar me Ligjin nr.7510 datë 8.08.1991.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”**, ratifikuar nga Këshilli i Ministrave në 27 Shkurt të vitit 1992.

Në këtë konventë gjendet përkufizimi se çfarë do të

17. Në nenin 54 të Kushtetutës, thuhet se:

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë të shtetit.
2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga martesë.
3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht në moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

kuptohet më tërmin “fëmijë”.¹⁸ Konventa përcakton detyrime për respektimin e të drejtave të fëmijëve, nisur nga parimi bazik i “interesit më të lartë të fëmijës”. Kjo Konventë dhe protokollat e saj shtesë përbëjnë një paketë të plotë standartesh për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve.

- **Karta Sociale Europiane**, miratuar me Ligjin nr.8960 datë 24.10.2002, njeh dhe garanton të drejtën e fëmijëve për të përfituar shërbime sociale. Në sferën e punësimit parashikon se të miturit nën 18 vjeç, të cilët aktivizohen në vende të caktuara pune, duhet t’i nënshtrohen kontrollit të rregullt mjekësor dhe punëdhënësit duhet t’i sigurojnë ata prej rreziqeve morale dhe fizike që mund të hasin gjatë punës. Karta detyron shtetet palë të mos lejojnë fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm të aktivizohen në disa punë, që pengojnë përvetësimin e plotë të këtij arsimimi.
- **Konventa e ILO nr.138 “Mbi moshën minimale të lejuar të punës”**, e ratifikuar në vitin 1998. Sipas Konventës, mosha minimale për punësim nuk mund të jetë më e vogël se mosha e mbarimit të arsimit të detyruar dhe në asnjë rast më pak se 15 vjeç.
- **Konventa e ILO nr.182 “Mbi ndalimin dhe veprimin për eliminimin e të gjitha formave të punës së fëmijëve”**, e ratifikuar në vitin 2001.
- **Konventa e Hagës e vitit 1993 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me birësimet ndërkombëtare”**, e ratifikuar me Ligjin nr. 8624 datë 15.06.2000.
- **Konventa Europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”**, ratifikuar me Ligjin nr.9359 datë 24.03.2005.
- **Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”**, parashikon mundësinë e barabartë të çdo personi fizik, për të pasur të drejta dhe detyrime civile brenda kufijve të përcaktuar me ligj, pra për të pasur zotësi juridike.
Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha

18. Shih nënin 1, të Konventës së OKB –se “Për të drejtat e Fëmijëve”.

e zënies së tij.¹⁹

Po sipas këtij kodi, zotësia juridike për të vepruar i lind çdo personi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe që është i aftë që me veprimet e tij/saj të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Zotësia juridike i njihet e kufizuar të miturve (fëmijëve) që kanë mbushur moshën 14 vjeç, të cilët në bazë të pëlqimit paraprak të përfaqësuesit ligjor, mund të disponojnë të ardhura nga puna e tyre, ti depozitojnë dhe disponojnë ato lirisht.²⁰

- **Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.** Ky kod parashikon masa të veçanta mbrojtje për të miturit (fëmijët), nga çdo punë që ka mundësi, të jetë e rrezikshme për shëndetin e tyre, të dëmtojë moralin, apo të ndërhyjë në shkollimin e fëmijës.

Mosha minimale e punës është përcaktuar 16 vjeç.²¹

- **Ligji nr.7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”**, që parashikon moshën 14 vjeç si moshën kur një individ ka përgjegjësi penale,²² ndërkohë që në moshën 16 vjeç veprimet e individit të cilat janë në kundërshtim me ligjin, janë të dënueshme. Masa e dënimit të dhënë në vendimet gjyqësore me heqje lirie për të miturit, nuk duhet të kalojnë gjysmën e kohës së dënimit të parashikuar nga ligji për atë veper penale,²³ dhe ka raste kur gjykata mund të evitohet dënimin me heqje lirie të të miturve duke urdhëruar vendosjen e tyre në “institucione edukimi”.²⁴ Keqtrajtimi fizik ose psikologjik nga kujdestari ligjor, shfrytëzimi i fëmijës nëpërmjet aktit të lypjes, apo detyrimi i tij për të punuar, për të siguruar të ardhura apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, është i klasifikuar në këtë kod si një veper penale e veçantë.²⁵

19. Shih nenin 2 të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.

20. Shih nenin 7 të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.

21. Mund të punësohen të mitur nga mosha 14-16 vjeç, vetëm gjatë pushimeve shkollore në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre. Shih nenin 98 të Kodit të Punës.

22. Shih nenin 12, të Kodit Penal.

23. Ibid.. neni 51.

24. Ibid .. neni 52.

25. Ibid .. neni 124/b.

- **Ligji nr.8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”**, që parashikon rregullat procedurale të mënyrës dhe subjektit që mund t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen e kujdestarisë ndaj të miturit. Në këtë kod njihet e drejta e dëgjimit të të miturit për çështjet që lidhen me vendosjen e kujdestarisë nga ana e gjykatës.²⁶
- **Ligji nr.7650 datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”, i ndryshuar me Ligjin nr.9695 datë 9.03.2007**, ky ligj përcakton procedurat që duhen ndjekur pas deklarimit të fëmijës së braktisur, deri në birësimin e tij.
- **Ligji nr.8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar**, mbulon një pjesë të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror. Përfituesit e këtij statusi janë individet nga mosha 0-25 vjeç.²⁷ Ky ligj parashikon një sërë përfitimesh për individet që gëzojnë statusin e jetimit, siç, vendosjen në institucionet private apo shtetërore të përkujdesit shoqëror, sigurimin dhe lehtësimin e së drejtës së tyre për arsimim, marrjen e masave për sistemimin e tyre me punë dhe përparësinë ndaj tyre gjatë procesit të punës, trajtimin me përparësi dhe me kushte lehtësuese për strehim, lehtësira në shërbimin shëndetësor dhe trajtimin me medikamente, udhëtimin qytetas falas me mjete private apo shtetërore.
- **Ligji nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”**.
- **Ligji nr.9062 datë 8.05.2003 “Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë”**, përcakton regjimin juridik të marrëdhënieve në familje, marrëdhëniet ndërmjet pjestarëve të familjes, vendin që fëmijët zënë në të, rregullon institutet e përgjegjësisë prindërore, të birësimit dhe kujdestarisë. Ky kod sanksionin parimin e rëndësishëm “të interesit më të lartë të fëmijës”,²⁸ i cili shërben si gur themeli, që kushtëzon përmbajtjen e të

26. Shih nenet 351/1, 352 dhe 356/1, të Kodit të Procedurës Civile.

27. Përfashtim nga ky përcaktim bëhet nëse individi jetim edhe pasi ka kaluar moshën 25 vjeç, nuk është trajtuar me strehim nga shteti dhe është në kushte të vështira jetese. Ky përcaktim gjendet në paragrafin 2, të nenit 2, të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar.

28. Shih nenin 2, të Kodit të Familjes.

gjithë legjislacionit tjetër, që rregullon marrëdhënien në familje dhe veçanërisht të drejtat e fëmijëve. Vënia mbi gjithçka e fëmijëve është tashmë një postulat i Kodit të Familjes.

- **Ligji nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar.** Rregullon politikat sociale në kuadër të programeve për strehim në njësitë e qeverisjes vendore. Si kushte sociale favorizuese për strehim parashikohet kategoria e individëve “jetim”, me moshë nën 30 vjeç.
- **Ligji nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar,** ka si objekt rregullimi, përcaktimin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore për individet dhe grupet në nevojë që nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike dhe të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror të tyre. Si kategori përfituese parashikohen ndër të tjerë edhe jetimët të cilët nuk janë në institucione.²⁹
Ligji parashikon ndër të tjera, rrugët dhe mënyrat e realizimit të procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe kalimin e kompetencave, përgjegjësi e fondeve në bashki dhe komuna, si dhe rritjen e rolit të qarkut. Njësitë e qeverisjes vendore marrin kompetenca e përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve sociale, identifikimin e familjeve dhe individëve në nevojë për ndihme ekonomike dhe pagesë të aftësisë së kufizuar.
- **Ligji nr.10347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.** Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën.
- **Ligji nr.69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.** Në këtë ligj përcaktohet se, sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e se ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin. Në veprimtarinë e institucioneve të këtij sistemi, interesi i nxënësit është

29. Shih nenin 2, të Ligjit nr.10399 datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.

parësor, si dhe mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.³⁰

- VKM nr.658 dhe nr.659 datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”.
- “Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale dhe e Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, miratuar me VKM nr.80 datë 28.01.2008, ndryshuar me VKM nr.1104 datë 30.07.2008.
- VKM nr.89 datë 26.01.2012 “Për percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë”.
- VKM nr.182 datë 13.03.2012 “Për miratimin e planit të veprimit për fëmijë 2012-2015”.
- VKM nr.265 datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës midis autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyra e procedimit të tij”, ky vendim krijon një mekanizëm pune për një sërë strukturash kryesisht në nivel vendor, për të identifikuar, referuar dhe ndërhyrë për rastet e fëmijëve në rrezik.
- VKM nr.266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.
- VKM nr.425 datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”.

30. Shih pikat 1 dhe 2, të nenit 6, të Ligjit nr.69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

7. Ndërhyrjet e Avokatit të Popullit.

Aktiviteti i Avokatit të Popullit për monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, ka qenë i përqëndruar në sigurimin e kushteve sa më të përshtatshme të jetesës e të mirërritjes së fëmijëve, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe referuar përcaktimeve të nenit 27, të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”, ku thuhet se:

“1. Shtetet Palë, njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

3. Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të venë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin”.

Avokati i Popullit, me inisiativë, ka kryer inspektime në një sërë Institucionesh Rezidenciale Publike të Përkujdesit Shoqëror. Fokusi kryesor i inspektimeve të kryera ka pasur të bëjë me krijimin e standardeve të pranueshme të jetesës së përditëshme, të fëmijëve që strehohen në këto institucione.

Më konkretisht, nga inspektimet e kryera ka rezultuar se:

- Shtëpia e foshnjës 0-6 vjeç, Korçë.

Avokati i Popullit i konsideron standartet e kësaj qendre si të pranueshme, dhe si një shembull i mirë që duhet implementuar edhe në institucione të tjera homologe. Problemi i vetëm në këto ambiente të kompletuara, ishte përzgjedhja e një stafi sa më të kualifikuar, i cili mund t'i bëjë ballë vështirësive dhe specifikave që kërkon mirërritja e këtyre fëmijëve. Kjo për të evituar në maksimum gabime të mundshme njerëzore, që mund të çojnë në ngjarje të rënda në dëm të shëndetit dhe jetës së këtyre fëmijëve.

Në inspektimin e kryer në vitin 2010, në takimin e bërë me Drejtuesen e kësaj Qendre, u informua se për një shërbim sa më të kualifikuar dhe cilësor, dilte e domosdoshme shtesa në organike për “kujdestare”. Në këtë qendër kishte 6 kujdestare. Aktualisht, shtesa me 2 kujdestare dhe edukatore ishte realizuar nga fondacionet kanadeze dhe franceze. Kontrata me fondacionin kanadez ishte deri në Mars 2011, ndërsa ajo me fondacionin francez deri në Gusht 2011. Prandaj dilte si problem imediat, shtesa në organike me 3 kujdestare.

Për të plotësuar një nga standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, siç është pasurimi i rrjetit të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, iu rekomandua Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe Drejtorit të Shërbimit Social Shtetëror:

- Marrja e masave për mundësinë e shtimit në organikë me 3 (tre) kujdestare.

- Shtëpia e Fëmijës 6-16 vjeç, Sarandë.

Avokati i Popullit pas inspektimit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror

- Marrjen e masave për ndryshimin e kuotës ushqimore prej 260 lekësh në ditë, pasi me rritjen e çmimeve kjo kuotë është e pamjaftueshme.
- Shtimin në organikë të një punonjesi social, i cili të ketë aftësitë e duhura profesionale të domosdoshme dhe të nevojshme për të trajtuar këtë grupmoshe.
- Shtimin e një fondi për blerjen e një automjeti apo marrjen me qera të një mjete transporti për këtë shtëpi fëmije.

- Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç, Vlorë.

Avokati i Popullit pas inspektimit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror:

- Marrjen e masave për rikonstrukcionin e tërë godinës ku strehohen fëmijë nga 0 deri në 6 vjeç duke evituar lagështirën.
- Shtimin e kuotës ushqimore, kjo referuar rritjes së çmimeve të tregut, e domosdoshme kjo për sigurimin normal të ushqyerjes së këtyre fëmijëve.

- Shtëpia e fëmijës 6-16 vjeç, Shkodër.

Avokati i Popullit pas inspektimit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror:

- Marrjen e masave për hidroizolimimin e taracës gjë e cila do evitonte lagështirën e madhe në shumë ambiente të shtëpisë së fëmijës 6-14 vjeç, Shkodër.
- Shtimin e kuotës së veshmbathjeve për këta fëmijë gjë e cila deri në atë kohë ishte përballuar me ndihmën e donatorëve.

- Shtëpia e foshnjës "Hans Kristian Andersen", Shkodër.

Inspektim i kryer në vitin 2009

Kjo qender shërben dhe si Qender komunitare për fëmijët nga 0-6 vjeç, specifikisht i shërben fëmijëve jetimë rezidenciale 0-

3 vjeç dhe fëmijëve me probleme sociale 0-6 vjeç. Megjithë punën e lavdërueshmë të personelit të kësaj qendre, si dhe të drejtueses së saj, u konstatuan disa probleme që kërkonin zgjidhje sa më të shpejte:

- Nevojitet rikonstruksioni i pjesshëm i kësaj godine. Emergjencë rikonstruksioni kishin sidomos tualetet e godinës, për arsye të lagështirës së madhe, që mund të ndikonte në shëndetin e fëmijëve.
- Po kështu nevojitet adaptimi në perputhje me kërkesat dhe nevojat e kohës së fëmijëve, i 5 dhomave të gjumit të kësaj godine.
- Domosdoshmëria e punësimit (qoftë dhe me kohë të pjesshme), të një doktori dhe të një psikologu për punën me fëmijët.
- U konstatua mungesa e financimit për argëtimin e fëmijëve jashtë Qendrës. Kjo ishte e domosdoshme për këta fëmijë, të cilët nuk mund të argëtoheshin vetëm brenda mureve të kësaj Qendre.
- Së fundmi, mungesa e një autoveture kushtëzonte së tepërmi lëvizjet e fëmijëve, aktivitetet social-kulturore dhe sidomos emergjencat e ndryshme me të cilat mund të përballen.

Avokati i Popullit pas inspektimit të kryer i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave:

- *Për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës, për evitimin e lagështirës në mure.*
- *Punësimin (qoftë dhe me kohë të pjesshme) të një doktori si dhe të një psikologu për punën me fëmijët.*
- *Planifikimin e fondeve të nevojshme për argëtimin e fëmijëve jashtë Qendrës në aktivitetet e ndryshme social-kulturore për fëmijë.*
- *Planifikimin e fondeve për blerjen e një automjeti për nevojat e lëvizjes së fëmijëve qoftë për aktivitetet social-kulturore, qoftë për raste të emergjencave të ndryshme me të cilat mund të përballen.*

Në inspektimin e kryer në vitin 2010, u konstatua se ishin realizuar përkatësisht, punësimi i një doktori dhe një psikologu për punën me fëmijët dhe kishte patur një shtesë të kënaqshme buxheti, për argëtimin e fëmijëve.

Nuk ishte zbatuar pika 1, e rekomandimit për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës dhe përsëri u konstatua lagështirë në muret e godinës.

Për nevojat e lëvizjes së këtyre fëmijëve, qoftë dhe për aktivitete social-kulturore, vijonte të mbetej i pazgjidhur problemi i disponimit të një automjeti për këtë Shtëpi Foshnjeje.

Ndërkohë vlen të theksohet vijimësia e bashkëpunimit dhe të donacioneve, për interesin më të mire të këtyre fëmijëve, bazuar në kontratën 3 palëshe Shtëpi Foshnje, Bashkisë Shkodër si dhe Fondacionit Amerikan "Hopes for the world".

- Shtëpia e Fëmijëve Parashkollorë 0-6 vjeç, Shkodër.

Inspektim i kryer në vitin 2009.

Kjo Qendër shërben dhe si qendër ditore për fëmijët nga 3-6 vjeç. Pra, qendra i shërben fëmijëve jetimë biologjike dhe fëmijëve me probleme sociale. Gjatë inspektimit konstatuam disa probleme, që kërkonin zgjidhje:

- Në tualetet e katit të dytë kishte nevojë për riparime, pasi në mure kishte lagështirë.
- Ishte mjaft e nevojshme pajisja me një lavatriçe+tharëse industriale, për vetë numrin e konsiderueshëm të fëmijëve të kësaj qendre dhe nevojat e tyre për një higjenë sa më të mirë.
- Ishte mjaft e nevojshme rinovimi i enëve të kuzhinës si dhe blerja e një sobe të re gatimi.
- Punësimi i një infermieri që mungonte në këtë qendër, konsiderohej mjaft i domosdoshëm për ndjekjen e mbarëvajtjes shëndetësore të fëmijëve.

Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave:

- *Për riparime të pjesshme të godinës, konkretisht meremetimi i mureve me lagështirë të katit të dytë.*
- *Pajisjen me një lavatriçe+tharëse industriale, për një higjenë sa më të mirë, si dhe blerjen e një sobe gatimi si dhe rinovimi i enëve të kuzhinës.*
- *Punësimin e një infermieri, për të ndjekur çdo ditë mbarëvajtjen e shëndetit të fëmijëve.*

Në inspektimin e kryer në vitin 2010, u konstatua se ishte realizuar vetëm pika e parë e rekomandimeve, ajo e riparimit të pjesshëm të godinës.

- Shtëpia e Foshnjës, Durrës.

Inspektim i kryer në vitin 2009.

U konstatua përkushtimi i stafit drejtues dhe personelit të Shtëpisë së Foshnjës Durrës për krijimin e ambjentëve dhe të kushteve mjaft të mira, mikpritese e për më tepër, duke dhuruar dashurinë si të një prindi të vërtetë për këta fëmijë. Por nisur nga parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, dhe me dëshirën që për këta fëmijë të bëhet çka është më e mira, *i është rekomanduar Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror, marrja e masave:*

- *Për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës, konkretisht çelje dritarësh për ndriçim e ajrosje të drejtëpërdrejtë të ambjentëve të kuzhinës e të një dhome gjumi në Godinën e Shkozetit. Po kështu meremetimi i mureve me lagështirë të kuzhinës në Godinën e Durrësit.*
- *Vendosjen e një gjeneratori për të dy godinat.*
- *Rregullimet brenda organikës ekzistuese për punësimin e një mjeku pediater, një kujdestari; një edukatori, dhe të një mirëmbajtësi (hidraulik+elektrik), për të dy godinat.*

Në Inspektimin e kryer në Shtëpinë e Foshnjës në Durrës në vitin 2010, u konstatua se nga Rekomandimet e bëra, ishte zbatuar pika 1 dhe pjesërisht pika 3.

Mbetej problem imediat vendosja e një gjeneratori dhe shtimi i zërit “shofer” në personel, pasi janë tre godina, të cilat ndodhen në vende të ndryshme dhe kanë vetëm një punonjës “mirëmbajtës”, i cili bënte edhe punën e shoferit, duke kryer transportimin e fëmijëve në ambulancë, spital, shkollë, kopësht etj,

- Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, për moshat 6-16 vjeç, Tiranë.

Avokati i Popullit pas inspektimit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror:

- *Marrjen e masave për rikonstrukcionin e plotë të godinës së Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, për evitimin e lagështirës së madhe e shtrirë kjo në gjithë ambjentet e saj.*
- *Shtimin në organike të një mirëmbajtësi ose ndryshimin e saj brenda numrit ekzistues për t’u kujdesur për përmirësimin dhe mbajtjen në punë të pajisjeve të domosdoshme për Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë.*

- Shtëpia e Foshnjës, për moshat 0-6 vjeç, Tiranë.

Avokati i Popullit pas inspektimit i rekomandoi Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror:

- *Marrjen e masave për rikonstruksionin e pjesshëm të godinës ku strehohen fëmijë nga 3 deri në 6 vjeç duke evituar lagështirën.*
- *Shtimin në organikë të një mjeku pediater e domosdoshme kjo për këtë kategori dhe kujdesin ndaj tyre*
- *Krijimin e kushteve të sigurisë dhe ruajtjes së këtyre ambjenteve me roje private për 24 orë.*
- *Shtimin e kuotës ushqimore dhe buxhetit për artikullin "Pampers", e domosdoshme kjo për sigurimin normal të jetesës dhe rritjes së këtyre fëmijëve.*

Në vitin 2010-2011 u bënë vizita në tre prej institucioneve, për të parë zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Shtëpia e Foshnjës, Vlorë.

Përsa i përket rekomandimeve për Shtëpinë e Foshnjës, Vlorë, janë zbatuar rekomandimet e bëra nga ana jonë dhe konkretisht është kryer rikonstruksioni i pjesës së jashtme të godinës, me një fond të Bashkisë së Vlorës prej 800 mijë lekësh, si dhe është realizuar shtimi i kuotës ushqimore nga 240 lekë në 290 lekë për çdo fëmijë, që nga 1 Janari i vitit 2010.

Për Shtëpitë e Fëmijës dhe Foshnjës Tiranë, rezultojnë pjesërisht të realizuara rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit.

Në inspektimin e bërë në vitin 2011 në Shtëpinë e Fëmijës 6-16 vjeç, Tiranë u konstatua se:

Drejtuesja e këtij institucioni veç problemeve të tjera, ngriti edhe shqetësimin lidhur me kujdesin dhe sigurinë e fëmijëve në shkollën 9-vjeçare "Osman Myderizi", Tiranë. Konkretisht, shqetësimi i saj konsistonte në largimin nga orët e mësimit të fëmijëve që frekuentojnë këtë shkollë, të cilët lëvizin lirisht brenda orarit mësimor dhe ku shkolla nga ana tjetër, nuk mbante asnjë përgjegjësi për largimin e tyre. Siguria e këtyre fëmijëve nga institucioni ku ata strehohen dhe deri në këtë shkollë, bëhej me anë të shoqërimit vajtje-ardhje me kujdestare. Largimet e shpeshta të fëmijëve nga orët e mësimit, janë bërë disa herë shqetësuese për rikthimin e tyre në orët e vona në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli", Tiranë.

Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorisë Arsimore, Tiranë: Marrjen e masave të menjëherëshme për sigurinë dhe frekuentimin e rregullt gjatë gjithë periudhës mësimore të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", që studiojnë në shkollën 9-vjeçare "Osman Myderizi", Tiranë.

Në shkresën nr.681/1 datë 5.08.2009 të Shërbimit Social Shtetëror, drejtuar Avokatit të Popullit, është konfirmuar ndjekja me përparësi e përmbushjes së rekomandimeve të dërguara, lidhur me këtë rast.

- Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç, Tiranë.

Drejtuesja e këtij institucioni veç problemeve të tjera që u konstatuan, ngriti edhe shqetësimin lidhur me kujdesin shëndetësor për fëmijët që strehohen në këtë institucion. Konkretisht për regjistrimin e tyre në një prej qendrave shëndetësore, (mundësisht më të afërt me pozicionin gjeografik të këtij institucioni), në Sauk apo Qendrën Shëndetësore nr.1, Tiranë. Nuk është e drejtë që, për kontrollin periodik të këtyre foshnjave si dhe vaksinimin e tyre, të mos ekzistojnë kartela përkatëse në një qendër shëndetësore, siç mundësohet edhe për fëmijët me prindër.

Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë, Tiranë:

Marrjen e masave të menjëherëshme për regjistrimin e këtyre fëmijëve në Qendrën Shëndetësore më të afërt dhe angazhimin e strukturave shëndetësore për kujdesin e tyre maksimal, ndaj foshnjave dhe fëmijëve që strehohen në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç, Tiranë.

Si në rastin e Shtëpisë së Foshnjës, për moshat 0-6 vjeç, Tiranë, ashtu edhe në rastin e Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç, Tiranë, rekomandimet e lëna janë përmbushur nga ana e Shërbimit Social Shtetëror,³¹ si dhe është konfirmuar në vazhdim për ndjekjen e çështjeve të buxhetit dhe kujdesit shëndetësor në dinamikën e tyre.

31. Shkresa nr.844/1 datë 2.08.2010 e Shërbimit Social Shtetëror, drejtuar Avokatit të Popullit.

7. Problematikat e konstatuara

- *Gjendja e fëmijëve jetimë dhe atyre që shfrytëzohen për punë, sipas raporteve të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Amnesty International.*

Një pasqyrë e gjendjes dhe problematikave që mbartin kategoritë e specifikuar të fëmijëve, konstatohet në raportet vjetore mbi gjendjen e të drejtave të njeriut për Shqipërinë, të paraqitura nga ana e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe nga organizata prestigjioze Amnesty International.

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2011, konstatohet se:

Ligji parashikon edukim të lirë për nëntë vjet dhe i jep të drejtën për këtë edhe shkollave private. Ndjekja e shkollës është e detyrueshme deri në vitin e nëntë, ose deri në 16 vjeç. Në praktikë, shumë fëmijë lanë shkollën më herët seç lejon ligji, për të punuar me familjet e tyre, sidomos në zonat rurale. Prindërit duhet të blejnë pajisje, libra, uniforma, dhe ngrohës ambienti që kanë qenë të paarrtshme për shkak të shtrenjtësisë për shumë familje, veçanërisht, për Romët dhe minoritetet e tjera. Shumë familje treguan këto kosto si një arsye për të mos dërguar vajzat në shkollë.

Abuzimi me fëmijët: Abuzimi me fëmijët, përfshirë abuzimin seksual ka ndodhur, megjithatë viktimat e kanë raportuar rrallë atë.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Në disa raste, fëmijë nën 18 vjeç janë përfshirë në prostitucion.

Fëmijët e shpërngulur dhe ata të rrugës: Mbeten një problem, sidomos fëmijët romë. Fëmijët e rrugës lypin ose bëjnë punë të vogla; disa migruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë kanë qenë në rrezikun më të lartë për trafikim dhe disa prej tyre u bënë viktimat e trafikut. Janë ndjekur penalisht shumë pak raste të trafikimit të fëmijëve.

Fëmijët në Qendra Institucionale: Ka pasur raporte se jetimët që kanë lënë kujdestarinë nga shteti, në moshën madhore janë përballur me sfida të dukshme në gjetjen e strehimit dhe shërbimeve të përshtatshme.³²

Ligji përcakton moshën minimale të punësimit, kohën dhe tipin e punës që mund të kryejnë fëmijët nën 18 vjeç....Ndërkohë që ligji parashikon se është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përgjegjëse për respektimin e kërkesave të moshës minimale përmes gjykatave, kanë munguar mjetet për një zbatim adekuat të ligjit. Inspektorët e punës, investiguan sektorin formal të punës, ndërkohë që rastet më të

32. Ky informacion gjendet në website: www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm#wrapper. Section 6. Discrimination, Societal abuses and Trafficking in Persons.

shumta të punës së fëmijëve ndodhen në sektorin informal.

Ligji penalizon shfrytëzimin e punës së fëmijëve dhe punën e detyruar, por qeveria nuk ka detyruar zbatimin efektiv të ligjit. Sipas një vlerësimi të CRCA (Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës-OJF) në vitin 2010, më shumë se 50.000 fëmijë nën 18 vjeç punuan së paku part-time. CRCA raportoi se, shumica e punëtorëve fëmijë, punuan si shitës në dyqane apo në rrugë, lypësa, fermerë apo barinj, shpërndarës droge, larës makinash, punëtorë në fabrikat tekstile, minatorë apo lustraxhinj këpucësh. Studimi sugjeroi se fillimi i punës ndodh në një moshë të re, herët në moshën 4 ose 5 vjeçare. Megjithëse kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, përgjithësisht policia nuk e zbatoi ligjin.³³

Në raportin për vitin 2010, konstatohen të njëjtat gjetje lidhur me problematikat e kategorive të sipërcituara të fëmijëve, duke përmendur specifikisht rastin e shpërthimit në Gërdec ku u vranë 26 persona, përfshirë këtu disa fëmijë të punësuar ilegalisht dhe ku plagosen qindra të tjerë, disa prej tyre rëndë.

Organizata Amnesty International, në raportin e saj për gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, për vitin 2012, konstaton se:

“Dhuna në famija mbetet e përhapur.... E shumta e incidenteve, përfshirë ato ku futet dhuna ndaj fëmijëve, kaluan të paraportuara.....Trafikimi i qënieve njerëzore vazhdoi, kryesisht ai i grave të reja dhe i vajzave për prostitucion të detyruar, por gjithashtu edhe i fëmijëve për lypje dhe punë të detyruar. Statistikat e nxjerra për vitin 2010 treguan se 12 vetë janë dënuar për trafik qeniesh njerëzore. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi Trafikimin e Qënieve Njerëzore, shënon se Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkrete për përmirësimin e strategjisë anti-trafik, por deklaroi se “korrupsioni i përhapur, veçanërisht në gjyqësor, vazhdoi të pengojë përgjithësisht zbatimin e ligjit anti-trafik dhe përpjekjet për mbrojtjen e viktimave”.³⁴

Sipas ligjit shqiptar, jetimët e regjistruar deri në moshën 30 vjeç, të cilët janë të pastrehë, kanë përparësi në rast të trajtimit me strehim social. Sidoqoftë, ligji është aplikuar shumë rrallë dhe shumë prej tyre vazhduan të jetojnë në konvikte shkollash në kushte shumë të keqija, ose u munduan për të paguar akomodim me qera të një cilësie të ulët.³⁵

33. Ky informacion gjendet në website: www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm#wrapper. Section 6. Discrimination, Societal abuses and Trafficking in Persons.

34. Ky informacion gjendet në website: files.amnesty.org/air12/air_2012_full_en.pdf

35. Ibid.

- Problematika të konstatuara nga OJF-të

Pa diskutim që OJF-të që veprojnë në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm për evidentimin e gjendjes, problemeve dhe ofrimit të rrugëve të zgjidhjes apo reduktimit të tyre.

Sikurse shihet në raportet e organizmave të sipercituar të huaj, një organizatë jofitimprurese që ka dhënë kontribut në këtë drejtim është CRCA, e cila ka evidentuar një sërë çeshtjesh që lidhen me shfrytëzimin e fëmijëve për punë.

Një tjetër OJF, e cila ka një kontribut të dukshëm në këtë drejtim është edhe "Instituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë". Nga hulumtimet e kryera ndër vite gjatë veprimtarisë të këtij instituti, rezulton se:

Një pjesë shumë e vogël e fëmijëve jetimë marrin ndihmë ekonomike. Asistenca sociale që garantohej nga shteti mbulon vetëm 5% të nevojave minimale të jetës së tyre. Një numër i vogël fëmijësh jetimë në mbarë vendin trajtohen në 9 qendra rezidenciale qeveritare dhe në 16 qendra joqeveritare.³⁶

Rrjeti i Shërbimit Social Shtetëror vepron në 12 zyra rajonale në të gjithë vendin, zyra të cilat nuk kanë funksionuar si duhet gjatë viteve të tranzicionit. Kjo ndodhe sepse në të shumtën e rasteve ky rrjet shërbimi ka qenë i korruptuar dhe informal...Qendra e rehabilitimit të fëmijëve jetimë të ngujuar nga gjakmarrja, që u ngrit në Poliçan me një vendim të bujshëm të Qeverisë në vitin 2008, dështoi për shkak të korrupsionit dhe mungesës së vizionit.³⁷

Prej 21 vitesh në konviktet e shkollave të mesme në rrethet Tiranë, Shkodër, Sarandë, Durrës, Berat, Korçë, Fier, Elbasan, Gjirokastër, ndodhen të strehuar qindra të rinj jetimë, të papunë.... në këto mjedise atyre nuk u sigurohet as minimumi jetik dhe s'kanë asnjë shpresë për të ardhmen e tyre. Vrasjet e ndodhura prej aplikimit të kanunit në zonat veriore të vendit, "kanë sjellë për pasoje 1400 jetimë që mbeten jo vetëm në varfëri e mjerim, por edhe me barrën e rëndë mbi supë për të gjetur drejtësinë e prindërve të humbur....Shumë jetimë dhe familje në gjakmarrje, kur nuk mund të gjejnë pajtimin dhe mbijetesën në kushtet shqiptare, kërkojnë si rrugë të vetme të largohen nga vendi.³⁸

Jetimët shqiptarë, ashtu si pjesa me e madhe e qytetarëve edhe pse i përkasin një popullsie me moshë të rë, nuk kanë mundësi biznesi dhe kanë humbur shpresën tek e ardhmja në vendlindje.

36. Rezolutë e Takimit Kombëtar të Jetimëve të Shqipërisë "Për integrimin e Shqipërisë bashkë me jetimët në Europën e Bashkuar", Tiranë, faqe 2, e shpallur nga Instituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, Tiranë, më 20 Maj 2012. Ky dokument gjendet në [website:www.nifao-orfan.org](http://www.nifao-orfan.org)

37. Ibid .. faqe 3.

38. Rezolutë e Takimit Kombëtar të Jetimëve të Shqipërisë "Për integrimin e Shqipërisë bashkë me jetimët në Europën e Bashkuar", Tiranë, faqe 4, e shpallur nga Instituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, Tiranë, më 20 Maj 2012. Ky dokument gjendet në [website:www.nifao-orfan.org](http://www.nifao-orfan.org)

Pushteti lokal nuk ka planifikim për mbështetjen sociale të jetimëve ashtu siç nuk ka planifikim për zhvillimin e ekonomisë qytetare e mjedisit. Korrupsioni po kthehet në një tipar të shëmtuar....Në Shqipëri, mungon kultura e protestës dhe e grumbullimit për të drejtat njerezore. Sipas të dhënave të fundit numri i fëmijëve lypës, i vjedhësve si dhe i fëmijëve që punojnë për të ushqyer familjen është rritur me më shumë se 30%, vitet e fundit. 60% e këtyre jetimëve mbeten shumë të varfër për gjatë gjithë jetës, ku edhe ekzistenca e tyre është në rrezik të vazhdueshëm.³⁹

Një numër i konsiderueshem i grave dhe vajzave të familjeve të varfëra i drejtohen prostitucionit klandestin për të mbijetuar. Viktimë e kësaj gjendjeje të mjerueshme janë veçanërisht vajzat jetime. Sot janë afro 600 fëmijë jetimë të policëve të rënë në detyrë. Janë 1050 fëmijë të tjerë jetimë nga komuniteti rom që mbeten përditë në sytë e të gjithë shoqërisë, që shihen me përbuzje e me përçmim tek lypin buzë rrugëve të qyteteve kryesore të vendit.⁴⁰

Sipas statistikave zyrtare, në periudhën 1996-2011, vetëm 29 nga 1150 persona me status jetimi kanë marrë banesë sociale.⁴¹

- Problematika të konstatuara nga institucionet shtetërore

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar, thekson se për këtë kategori fëmijësh është e domosdoshme ndërhyrja multidisiplinare me ekspertë nga fusha dhe institucione të ndryshme. Një nga kategoritë më të ekspozuara ndaj shfrytëzimit për punë, lypësi, apo krimeve të ndryshme janë fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile. Deri tani janë evidentuar dhe regjistruar në gjendjen civile, rreth 25 fëmijë të paregjistruar...⁴²

Fakt është se, numri i rasteve të dhunës në familje të evidentuara dhe trajtuara nga ana e strukturave të policisë së shtetit, ka ardhur në rritje. Veçanërisht për rastet e fëmijëve të dëmtuar nga ushtrimi i dhunës në familje, sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Brendshme, evidentohet se numri i trajtuar dhe marrë në mbrojtje nga Policia e Shtetit gjatë viteve të fundit tregon për impenjim dhe angazhim në këtë fushë.⁴³

39. Ibid .. faqe 5.

40. Ibid .. faqe 6.

41. Ibid .. faqe 7.

42. Ky informacion gjendet në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë nr.4078/1 date 20.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

43. Sipas informacionit të dhënë në shkresën nr.7782/4 datë 30.01.2013 të Ministrisë së Brendshme, numri i rasteve të dhunës në familje të evidentuara dhe trajtuara nga Policia e Shtetit, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", rezulton përkatësisht sipas viteve: 2008-822 raste; 2009-1217 raste; 2010-1998 raste; 2011-2181 raste dhe 2012-1860 raste. Lidhur me rastet e dhunës në familje ndaj fëmijëve rezultojnë: 2008-77 raste; 2009-49 raste, 2010-120 raste; 2011-98 raste; 2012-46 raste.

Në veprimtarinë e ushtruar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, nisur nga inspektimet e realizuara deri në këtë kohë, konstatohet se strukturat rezidenciale publike dhe jo publike për fëmijë kanë bërë progres në implementim standardesh shërbimi, por ende ka vështirësi dhe paqartësi në disa drejtime.⁴⁴

Këto vështirësi konstatohen në faktin se ende institucionet janë të fokusuara në zbatimin e standardeve që lidhen me aspektet fizike, dhe kanë vështirësi në zbatimin e standardeve që lidhen me aspektet psiko-sociale të fëmijëve, riintegrimin, pjesëmarrjen e prindërve e të afërmve në procesin e hartimit të planeve individuale, lidhjet me komunitetin etj. Vërehen mangesi të personelit në drejtim të figurave profesionale dhe kapaciteteve/kualifikimeve profesionale për trajtimin e fëmijëve sipas grup-moshave, zhvillimit psikologjik e sipas nevojave të veçanta të tyre.

Vështirësi konstatohen në funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe në adresimin e nevojave të fëmijëve. Janë evidentuar ambiente të cilat kanë nevojë të meremetohen për t'u përshtatur me kërkesat e standardeve të pranuar të banimit. Janë hasur vështirësi në zbatimin e procedurave, hartimin e planeve të përkujdesit social sipas formatit të miratuar, si dhe në disa institucione që kujdesin e bazojnë në parimet e bamirësisë, ka vështirësi për të kuptuar e zbatuar procedurat e parashikuara në standardin për ankimimin.

Ndjekja e procedurave për marrjen e kujdestarisë ligjore me vendim gjyqate, po ecën me ritme të ngadalta për shkak të zvarritjes së proceseve gjyqësore, neglizhencës së personelit dhe vështirësive për të kontaktuar me familjaret e fëmijëve të vendosur në institucione. Ka dalë e nevojshme dhe si vështirësi njëkohësisht, që në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror publike dhe jopublike, të aplikohen tipologji të reja të shërbimeve si, shtëpi familje.⁴⁵

Gjatë procesit të decentralizimit të kompetencave nga pushteti qendror tek qeverisja vendore, janë vërejtur disa problematika që lidhen me përgjegjësitë që tashmë i kalojnë dhe duhet të marrë përsipër qeverisja vendore në këtë kuadër.

Më konkretisht, sipas konstatimeve të Inspektoriatit Shtetëror të Punës :

- në përgjithësi qeverisja vendore nuk është përfshirë sa duhet në ushtrimin e përgjegjësive për administrimin

44. Ky informacion gjendet në shkresën e Inspektoriatit Shtetëror të Punës nr.1537/1 datë 20.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

45. Shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli", Tiranë, është rikonstruktuar këtë vit dhe e ka kthyer shërbimin në tipe apartamente të ndara sipas moshës dhe seksit për fëmijët jetimë të këtij institucioni. Informacioni është cituar në shkresën e Inspektoriatit Shtetëror të Punës nr.1537/1 datë 20.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

- efektiv dhe monitorimin e institucioneve të transferuara në varësinë e njësisve të kësaj qeverisjeje,
- mungesa e kapaciteteve dhe mundësitë e kufizuara financiare bëjnë që qeverisja vendore të mos i përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve vulnerabel.⁴⁶
 - procesi i ngritjes së Komisionit të Vlerësimit të nevojave dhe kërkesave për sistemim të klienteve në institucionet rezidenciale në rang Qarku dhe Bashkie, nuk funksionon siç duhet.
 - lëvizjetet personelit dhe drejtuesve në institucionet publike të përkujdesit shoqëror, ndikojnë në performancën dhe nivelin e shërbimeve të ofruara në këto shërbime.
 - vërehen probleme të moskoordinimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit mes qeverisjes vendore, OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore, për sigurimin dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve në mbështetje të grupeve në nevojë.

Në rrjetin e institucioneve publike dhe jo publike të përkujdesit për fëmijët, ofrohen, shërbime psiko-sociale dhe integruese, shërbim shëndetësor, shërbim mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim edukues, mbështetje për familjen. Nga vlerësimi i shpërndarjes gjeografike të këtyre shërbimeve, vihet re një përqendrim më i madh i shërbimeve të OJF-ve, kryesisht në Qarkun e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit dhe në disa qendra urbane. Ndërsa zonat periferike dhe rurale kanë me pak akses në shërbime mbështetëse dhe mbrojtëse për fëmijët në nevojë.⁴⁷

Grup moshë e fëmijëve përfitues të të gjithë shërbimeve rezidenciale të ofruara është 0-16 vjeç, (sipas VKM nr.425 datë 27.06.2012). Mbi moshën 16 vjeç shërbimet mbështetëse për këta fëmijë janë të pakta dhe ato jepen kryesisht nga OJF-të që, mbështesin këtë grup moshe me programe integruese në komunitet, nëpërmjet nxitjes së jetesës së pavarur.⁴⁸

- Problematika të evidentuara në media

Fëmijët pa përkujdesje prindërore, qofshin këta jetimë biologjike apo socialë, “detyrohen” të largohen nga përkujdesi social që në moshën 15 vjeç. Dalin adoleshentë nga shtëpitë e fëmijës dhe në të shumtën e rasteve, sipas psikologeve, janë

46. Rezulton se nuk ka shërbime të reja të ngritura për fëmijët vulnarbel, përveç një qendre ditore në Tiranë dhe Shkodër. Ky informacion gjendet në shkresën e Inspektoriatit Shtetëror të Punës nr.1537/1 datë 20.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

47. Shkresa e Shërbimit Social Shtetëror nr.1064/1 datë 25.09.2012, drejtuar Avokatit të Popullit.

48. Ibid.

të predispozuar të bien pre e sjelljeve të rrezikshme, si: droga, duhani dhe alkooli. Me arsim 9-vjeçar, pa mundësi punësimi dhe pa strehë mbi kokë, e vetmja mundësi shpëtimi mbeten konviktet e shkollave të mesme profesionale. Burimet financiare që mbështesin këta të rinj për shërbime mjekesore, punësim dhe strehim janë të pamjaftueshme. Të dalesh nga përkujdesi në moshën 15-vjeçare është shumë herët nga pikepamja psikologjike dhe sociale e zhvillimit, duke marrë parasysh veçanërisht mungesën e prindërve dhe të mosmbështetjes nga strukturat shtetërore. Një tjetër problem që ngrenë përfaqësuesit e fshatrave SOS është edhe fakti që legjislacioni aktual nuk i adreson çështjet e atyre që quhen “jetimë socialë”, të cilët nuk kanë mundësi të përfitojnë nga shërbime sociale. Legjislacioni që, përcakton punësimin dhe strehimin, si dhe shërbimet shëndetësore falas nuk implementohet. Mbështetja e vetme që u jepet këtyre të rinjve është ndihma ekonomike, e cila gjithsesi rezulton të jetë e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të jetesës.

Nivelet e tyre të ulëta të edukimit influencojnë negativisht në shanset e tyre për punësim. Punët që bejnë të rinjtë janë zakonisht joformale, të paguara pak, pa kualifikimin e nevojshëm dhe ku nuk paguhen sigurimet shoqërore. Si rezultat, të rinjtë nuk mund të përfitojnë as nga shërbimet shëndetësore falas. Shumë të rinj nuk mund të përballojnë koston e jetesës, nuk kanë mundësi strehimi, nuk mund të paguajnë qiranë dhe një pjesë e tyre mbeten të pastrehë. Vetëm një pjesë e vogël e të rinjve pa kujdes prindëror kanë përfituar nga programet qeveritare të strehimit. Konviktet e shkollave të mesme mbeten shpesh e vetmja mundësi strehimi për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve.

8. Konkluzione:

Nga një analizë tërësore e të gjithë informacionit dhe gjetjeve paraprake të sjella në këtë raport, bazuar në kontributin e të gjithë aktorëve të kësaj fushe, në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mund të arrijme në disa konkluzione:

Fëmijët jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe fëmijët që shfrytëzohen për të punuar, përfaqësojnë kategori sociale të cilat kanë marrë përpjestime shqetësuese në periudhën e tranzicionit dhe që sot njihen si kategori vulnerabël.

Gjendja reale e tyre dhe dinamika e zhvillimit tërësor të shoqërisë në vend, nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtet-shoqëri, për të siguruar një mjedis ku fëmijët e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata, kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues. Si një ndërmarrje parapërgatitore e domosdoshme, del nevoja e realizimit të studimeve zyrtare nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore, në lidhje me numrin e fëmijëve jetimë, si dhe të atyre që shfrytëzohen për punë, shkaqeve të këtij "statusi", të konstatuar nga studimet, dinamikës së zhvillimit të këtyre kategorive, tendencave pozitive e negative në këtë kuader, politikave shtetërore dhe rrugët e zgjidhjes për përmirësimin e gjendjes në një perspektivë afatgjatë.

Për të mundësuar krijimin e këtij mjedisi, nevojitet të merren masa në nivel të përgjithshëm për të siguruar:

- Zhvillim ekonomik për të rritur të ardhurat e familjeve dhe standardin jetësor: duke mbështetur rritjen dhe shpërndarjen e burimeve në nivel të përgjithshëm, si dhe duke mbështetur përpjekjet e familjeve në nevojë për të krijuar të ardhurat e domosdoshme. Lufta ndaj varfërisë është kryefjala e të gjithë përpjekjes për një zhvillim sa më të mirë të fëmijërisë, të fëmijëve jetimë dhe të reduktimit maksimal të shfrytëzimit të punës së fëmijëve;
- Arsimit cilësor, gjithëpërfshirës, pa pagesë dhe i detyrueshëm për të shtuar kapitalin njerëzor. Arsimit cilësor do të shërbejë si premisë për rritjen e shanseve për të gjetur një punësim sa më të përshtatshëm dhe lëvizshmëri më të madhe ekonomike e sociale për të shpëtuar nga kurthi i varfërisë, si dhe krijimin e një force punë më të aftësuar dhe kualifikuar që mund të çojë drejt një ekonomie më konkurruese;
- Zbatim të ligjeve kundër punës së fëmijëve, dhunës ndaj fëmijëve, ligjeve për arsimin e detyrueshëm, si dhe të ligjeve që në menyrë indirekte synojnë dënimin e individëve abuzues me fëmijët;

- Ndryshim pozitiv në mentalitetin shoqëror ndaj fëmijëve, në rang familjeje, punëdhënësish dhe institucionesh, për eliminimin e punës së fëmijëve;
- Shërbime sociale, si dhe një mbështetje të përshtatëshme dhe të vazhdueshme për vetë këto kategori fëmijësh, si dhe familjet e tyre, për të përballuar realitetin në të cilin zhvillohet fëmija.
- Marrjen e masave për të reduktuar fenomenin e ekonomisë informale dhe të gjithë pasojave negative që ajo sjell, si dhe një luftë të pandërprerë ndaj fenomenit gërryes të korrupsionit, që aktualisht ka pushtuar shumë aspekte të jetës së njerëzve. Ndërtimin e një tregu pune që respekton të drejtat bazë të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.
- Puna konkrete për të siguruar një mjedis sa më mirëqenës për kategorite target në këtë raport, shërben si masë parandaluese për një sërë dukurish të tjera negative të shoqërisë sonë, siç është krimi i trafikimit të fëmijëve, përfshirja e vetë fëmijëve në grupe kriminale apo në kryerjen e krimeve të ndryshme, prostituimi etj.

Lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve për punë

- Në legjislacionin në fuqi është përcaktuar qartë mosha kur një fëmijë mund të përfshihet në sistemin e punës. Sipas nenit 98 të ligjit Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës” një fëmijë nuk mund të punësohet kur është nën moshën 16 vjeç. Këtu, sipas nenit 99, bëjnë përjashtim rastet kur fëmijë të moshës 14-18 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre. Legjislacioni është po ashtu i specifikuar edhe për llojin e punës, kushtet e punës, kohëzgjatjen në rastet kur fëmijët lejohen të punësohen, si dhe ndëshkimet në rastet e kundërvajtjeve lidhur me punësimin e fëmijëve. Megjithatë, në legjislacionin ekzistues nuk adresohen rastet e shfrytëzimit përmes punës së fëmijëve në sistemin familjar dhe dënimet përkatëse. Kjo përbën një zbrazëti të madhe në kushtet kur fenomeni i punësimit të fëmijëve prej prindërve ose prej tutorëve të tjerë (shites ambulante, punët bujqësore, etj) kur fëmija është në moshë shkollë është mjaft i përhapur.
- Nga tërësia e ligjeve për dhunën kundër fëmijëve, paketa e ligjeve që kanë të bëjnë me parandalimin e formave të ndryshme potenciale të dhunës kundër fëmijëve në procesin penal si dhe e ligjeve që lidhen me vuajtjen e dënimit nga ana e të miturve janë më të specifikuar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ligjet për braktisjen e fëmijëve, për mbrojtjen e fëmijëve në procesin e birësimit, për mbrojtjen e fëmijëve pa

atdhe dhe fëmijëve azilkërkues, si dhe për ligjet lidhur me trafikimin e fëmijëve për qëllime prostitucioni dhe për qëllime përfitimi material. Këto të fundit duket se reflektojnë më thellë parimet themelore të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve. Megjithatë, duhet vënë në dukje, mungesa e dispozitave ligjore lidhur me rehabilitimin e fëmijëve që kanë qenë viktimë të dhunës ose dëshmitarë të dhunës.⁴⁹ Kodi i Familjes, ka disa nene ku trajtohet problemi i kujdesit të shtetit ndaj fëmijëve të braktisur. Me përjashtim të këtij rasti nuk ekziston asnjë dispozitë tjetër që të adresojë domosdoshmërinë e rehabilitimit të fëmijëve të traumatizuar nga dhuna, si dhe të institucioneve dhe shërbimeve sociale të posaçme për to.

- Në legjislacionin shqiptar nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë detyruese për raportimin e akteve të dhunës që ushtrohen kundër fëmijëve nga qytetarët si dhe nga profesionistët, në përgjithësi, në institucione të ndryshme, në shkolla etj. Ligji detyron në përgjithësi çdo qytetar që të raportojë çdo veper penale të dënueshme me mbi 5 vjet burgim, (në rastet kur është dëshmitar), por kjo gjë nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhunës kundër fëmijëve. Megjithatë, edhe në këtë rast legjislacioni është i mangët, pasi nuk parashikon masat ndëshkuese në rast se qytetarët nuk raportojnë. Kësisoj, raportimi i qytetarëve mbetet një çështje e ndërgjegjes së tyre personale. Në rastin e profesionistëve ekziston një kontradiktë mes përgjegjësisë për të raportuar dhe përgjegjësisë për të ruajtur konfidencialitetin, në rastin e punës së tyre me fëmijët.
- Në legjislacionin shqiptar nuk parashikohen, po ashtu, edhe rregulla të veçanta procedurale në lidhje me dhunën kundër fëmijëve. Duket se edhe në rastet e denoncimit të dhunës kundër fëmijëve në prokurori, praktikohen rregullat e përgjithshme procedurale, të cilat janë shumë të detajuara. Në rastet e dhunës kundër fëmijëve që ndodhin në shtëpi, institucione apo mjedise publike etj., që nuk denoncohen në prokurori, atëherë më së shumti ato trajtohen rast pas rasti në mjedisin familjar apo në organet drejtuese të institucioneve pa ndjekur ndonjë procedure të caktuar. Ndërkohë, megjithëse në ligj është shprehur në mënyrë eksplicite e drejta e ankimit për çdo qytetar që mendon se i janë shkelur të drejtat, nuk ekzistojnë procedura specifike për ankimin ndaj rasteve të dhunës kundër fëmijëve që ndodhin në kontekste të caktuara: shtëpi, konvikte, institucione të shëndetit mendor, në rrugë,

49. Ligji Nr.44/2012 "Për shëndetin mendor" trajton një sërë masash parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor të individit në tërësi dhe, në këtë kuadër, edhe të fëmijëve. Megjithatë, ky ligj nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë të miturit.

mjedise sportive, etj

- Reduktimi i punës së fëmijëve, duhet vlerësuar si një proces i karakterizuar më tepër nga zvogelimi i përfshirjes së fëmijëve në radhët e fëmijëve që punojnë sesa në tërheqjen e atyre që tanimë punojnë. Duke pasur parasysh këtë proces dinamik, ai nuk le të kuptohet se fëmijët që tanimë janë të përfshirë duhet të injorohen- sidoqoftë theksi duhet vënë tek parandalimi si një rrugë parimore për eliminimin e qëndrueshëm të punës së fëmijëve.

Për fëmijët jetimë:

- Fëmijët dhe të rinjtë që kanë humbur kujdesin prindëror vuajnë nga diskriminimi dhe shumë disavantazhe, si pasoje e mosofrimit të shërbimit dhe vëmendjes nga strukturat publike shtetërore. Kuadri aktual ligjor kërkon përmirësime për sa u përket të rinjve që largohen nga përkujdesja, duke adresuar sfidat e tyre, për të zhvilluar strategji më të mira dhe shërbime të tjera për ta. Statusi i përkujdesjes në institucionet rezidenciale vështirëson të ardhmen e të rinjve që largohen nga përkujdesja dhe thekson disavantazhet dhe vunerabilitetin e tyre. Statusi ligjor i fëmijëve në përkujdesje të moshës 16-18 vjeç nuk është i rregulluar. Legjislacioni aktual nuk përmban përcaktime ku të specifikohen përgjegjësitë e shtetit për këtë grup-moshe. Sistemi formal i përkujdesit mbeshtetet nga një sërë rregullash, ligjesh dhe institucionesh. Shërbime institucionale publike dhe jopublike sigurohen nga qeveria qendrore, qeveria lokale, organizata dhe të tjerë ofrues shërbimesh.
- Vendi ynë nuk ka një sistem ligjor të mjaftueshëm që mbulon nevojat e të rinjve që janë në përkujdesje apo që dalin nga përkujdesja, veçanërisht të atyre që largohen shumë më herët. është i nevojshëm krijimi i shërbimeve pas përkujdesjes, qëndrimi në përkujdesje deri në përfundim të shkollës së mesme, ngritja e qendrave ditore pritëse që ofrojnë shërbime për të rinjtë (16-18 vjeç) dhe implementimi i politikave të trajnimit profesional dhe punësimit për kategoritë e të rinjve që janë larguar nga përkujdesja. Nevojitet gjithashtu, përmirësimi i legjislacionit për daljen nga përkujdesja dhe krijimi i një kuadri ligjor për të rinjtë që largohen prej saj, i cili thekson rolin e vendimmarrësve në mbështetjen e të rinjve për sa i përket strehimit dhe punësimit, sigurimit të ndihmës ekonomike dhe sociale.
- Drejtim i rëndësishëm i masave që duhet të merren në këtë kuadër është nisja e shërbimeve të reja për të rinjtë (fëmijët), informimi dhe këshillimi, shërbime komunitare e

pjesëmarrëse dhe advokim për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre.

- Trajtimin e duhur ligjor të individëve jetimë, për përfitimin real të të gjitha lehtësirave që ofron Ligji “Për statusin e jetimit”, por edhe legjislacioni aktual në fuqi, jo vetëm për kohën që këta individë janë nën përkujdesje shoqërore, por edhe pas kalimit të moshës 18 vjeç dhe cilësimit të tyre si të rritur. Strehimi, punësimi, shërbimet përkatëse të përkujdesjes shoqërore, përjashtimi nga taksa të caktuara, janë të drejta të këtyre individëve, që nga ana tjetër kërkojnë një anagazhim konkret dhe real të shtetit për plotësimin e tyre.
- Del i nevojshëm rishikimi i dispozitave të Ligjit “Për Statusin e Jetimit”, në kushtet kur kompetencat për zbatimin e tij kanë kaluar nga organet e pushtetit qendror, tek organet e qeverisjes vendore dhe kur vetë zhvillimi i shoqërisë shqiptare dhe i marrëdhënieve në tërësi ka evoluar, duke marrë dimensione dhe kuptime të reja.

Në një kuadër të përgjithshëm për kategoritë target të raportit, është e nevojshme të ndërmerren hapa konkretë, për:

- Konsolidimin dhe përmirësimin e sistemit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë.
- Nxitjen e procesit të decentralizimit të shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në komunitet. Krijimin e kapaciteteve dhe mundësive financiare të mjaftueshme në qeverisjen vendore, për ngrijtjen e shërbimeve të reja në perputhje me nevojat e fëmijëve në nevojë, si dhe një koordinim më të mirë mes këtij pushteti, organeve të qeverisjes qendrore dhe OJF-ve që veprojnë në këtë fushë, për këtë qëllim.
- Ofrimin e shërbimeve cilësore në institucionet publike dhe jopublike të përkujdesit për fëmijët, duke respektuar dhe aplikuar standartet e ambienteve fizike dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit për stafet e specializuara. Në lidhje me standartin për procedurat e mbrojtjes, çdo punonjes i ri në institucion duhet të marrë një trajnim të parë mbi procedurat e mbrojtjes dhe çdo institucion ta vendosë si të detyrueshëm marrjen e këtij trajnimi. Trajnimi duhet të përfshijë përkufizime të qarta mbi konceptin e abuzimit, format dhe manifestimet si dhe pasojat tek fëmijët nga perspektiva e të drejtave dhe zhvillimit të fëmijës. Ky trajnim të rifreskohet në vazhdimësi, në veçanti me aspektet e trajtimit dhe ndihmes ndaj fëmijës.

- Forcimi i cilësisë dhe aksesit në shërbime të tjera të institucioneve rezidenciale për të siguruar përmbushjen e nevojave të fëmijëve. Ky është një aspekt mjaft i rëndësishëm nëse mbajmë parasysh që ky grup fëmijësh ka nevoja të veçanta psikosociale, herë herë janë të traumatizuar, apo kanë probleme të shëndetit mendor. Shpesh herë këto shërbime të specializuara mungojnë, por njëkohësisht mund të ndodhë dhe që nuk njihen. Është e rëndësishme që personeli dhe drejtuesit e institucioneve të njohin këto shërbime, specialitetet e tyre dhe krijojnë lidhje bashkëpunimi për të adresuar nevojat e fëmijëve.
- Nxitja e deinstitutionalizimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale nëpërmjet transformimit të tyre në formën Shtëpi- Familje, ngritja e shërbimeve ditore dhe komunitare brenda këtyre qendrave. Ofrimi i formës së shërbimit Shtëpi-Familje, sikurse në rastin e aplikuar në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë, në të gjitha institucionet publike rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore. Në procesin e deinstitutionalizimit, është e domosdoshme të ndiqet përqsja sistematike edhe në mënyrën sesi duhet të trajtohen fëmijët në rrezik për përkujdes institucionale, si dhe i gjithë procesi i përkujdesit, me synimin e nxjerrjes së familjes dhe fëmijës nga cikli i rrezikut dhe fuqizimi i familjes për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga familja.
- Promovimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe shërbime alternative, të cilat zbusin institucionalizimin e fëmijëve, shërbimi i kujdestarisë në familje, birësimi dhe rikthimi në familje biologjike.
- Fuqizimi i kapaciteteve në nivel qendror dhe rajonale i strukturave që punojnë me fëmijët, trajnimi i vazhdueshëm i stafeve të shërbimeve sociale. Vihet re se, njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme, janë ende të kufizuara me gjithë trajnimet që janë ofruar herë pas here nga organizata të ndryshme dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Për këtë qëllim, programet e trajnimeve për të gjithë personelin pavarësisht përvojës, rolit, detyrave, duhet të ofrohen në vazhdimësi dhe të lidhura me ndikimin në cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe të cilësisë së mirëqenies së fëmijëve në institucionet e përkujdesjes.